

VENDIM
Nr. 95, datë 27.2.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 356, DATË 19.4.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘RIKUALIFIKIM URBAN NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË’, FAZA I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 356, datë 19.4.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në tabelën me listën e pasurive që preken nga projekti “Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë, faza I”, shtohet numri rendor 18 (tetëmbëdhjetë), sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlera shtesë, prej 3 952 337.5 (tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM URBAN NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË, FAZA I”, (SHTESA).

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kadastral e	Nr. Pasurisë	Rreth i	Sip. e ndërtimi t (m ²)	Sip. e truallit t (m ²)	Çmimi i ndërtimi t (l/m ²)	Çmimi i truallit t (l/m ²)	Vlera e ndërtimi t (lekë)	Vlera e truallit t (lekë)	Vlera Totale (lekë)	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
18	Bashkëpronarët Çakëri, Koka, Kreshpaj dhe Alizoti	ZK. 8602	2/125	Vlorë	—	362.5	—	10,903	—	3,952,337.5 0	3,952,337.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit “truall”.

VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT

3,952,337.50

